




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	2-0/DPK
Dep.	02
Nr. i faq.	
Broj stranica	
Nr. pages	
PRISHTINE	
Nr. Prot.	01-4057/15
Bri Prot.	
Prot No	
Data	
Datum	
Date	11.11.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.11.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2502-15 për z.Murat Hoxha –deputet në Kuvendin e Kosovës, për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Hoxha ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2502-15, për Zyrtarin e lartë, z.Murat Hoxha–Deputet në Kuvendin e Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Hoxha është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Hoxha, është deklaruar se do të filloj t'i bëjë ndryshimet e kërkua në Agjensionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, edhe pse ai ka menduar se ky biznes do të duhej të ishte i shuar.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar një shkresë zyrtare (e-mail) në të cilin ka paraqitur vështirësitë që ka në shuarjen e këtij biznesi, sepse pronarët real të saj janë persona të huaj dhe jetojnë jashtë Kosove.

Meqënse afatet e dhëna ligjore për këto ndryshime të dhëna nga Agjencia kundër Korrupsion kalonin, AKK ka qenë e detyruar që zyrtarit të lartë z.Hoxha t'i bëjë edhe shkresën e dytë që quhet "Paralajmerim..." me të cilën zyrtarit Hoxha i është dhënë një afat i ri, i caktuar sipas ligjit, për të bërë ndryshimet e nevojshme, në të kundërtën lënda do të procedohej tutje sipas ligjit.

Pas kësaj, z.Hoxha, brenda afatit ligjor, në Agjencinë kundër Korrupsionit ka dërguar shkresën zyrtare (DPK/DPKI-03-02-3946/15), e lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te biznesi Kompani e huaj "Blominfo A/S" Përfaqësia në Kosovë, ai tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtori i DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

